



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2737/ 11 Prot.

Datë 04/12/2025

V E N D I M
Nr. 1792/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/12/2025 mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1693/2025, datë 17.11.2025 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra*”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “*Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos*”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Teknoxgroup Shqipëri*” SHPK, me NIPT J61926006P, me adresë: *Autostrada Tiranë – Durrës, Km 16, Fshati Muçaj, Vorë*.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Klos.
Adresa: Rruga “Jaho Hoxha”, Ndërtesa nr. 2, Hyrja nr.2, Klos.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “*Power Industries*” SHPK, me NIPT L92713601Q, me adresë: *Rruga “Xhorxh Soros” Lagjia “18 Shtatori”, Nr. 1524, Gjirokastrë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datën 17.11.2025 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 1693/2025 ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Teknoxgroup Shqipëri” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2689/2 prot datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2737/8 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia Klos, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1693/2025 datë 17.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: “Blerje makinerie për

pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2689/2 prot datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2737/8 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia Klos, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1693/2025 datë 17.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”*, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: *“Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me fond limit 6,727,550 (gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.*

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vëret se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1693/2025 datë 17.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës, duke kualifikuar operatorin ekonomik *“Teknoxgroup Shqipëri”* SHPK në këtë procedurë prokurimi. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP Nr. 1693/2025 datë 17.11.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, nenit 46 pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Mallra”*, me Nr. REF-49789-06-02-2025, me objekt: *“Blerje makinerie për pastrimin e kanaleve vaditëse të Bashkisë Klos”, me*

fond limit 6,727,550 (*gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Klos.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

